



Kolegji Riinvest  
Zyra për planifikim akademik

## Praktika në Korporata EKB0036

Data e aprovimit:	Data
Verzioni:	Verzion
ECTS:	6
Bartësi i lëndës:	Argjenta Plakolli
Email:	argjenta.plakolli@riinvest.net
Telefoni:	+377 44 772 001

### Hyrje:

Në këtë lëndë, studentët do të kenë mundësi që nga afër të shohin se si funksionon puna praktike dhe tregu i punës në përgjithësi. Studentët pas ndjekjes së një sërë punëtorive në lidhje me përgatitjen e dosjes personale të karrierës së tyre si dhe pas një sërë sesioni ligjeratash më ligjerues mysafirë nga industritë përkatëse, do të bëjnë punën praktike në njërin nga korporatat dhe/ose institucionet bankare partnere. Kjo paraqet një mundësi të mirë që ta aplikojnë dijen e fituar nëpër lëndët tjera përgjatë studimeve dhe njëkohësisht të përgatiten për tregun e punës para diplomimit dhe pas tij.

### Qëllimet

Qëllimi i kësaj lënde është që të iu ofrojë studentëve që të mbulojnë zhvillimin e tyre profesional për gradën që do të fitohet duke reflektuar gjithçka që ata kanë mësuar deri më tani dhe që do të mësojnë e trajnohen përgjatë kësaj lënde në të dyja versionet- në dy mënyra: në dimension profesional në jetën e përditshme si dhe paraqitjen e tyre online. Kjo lëndë ka për qëllim aftësimin e studentëve që në mënyra të mirëfilltë të përgatisin dosjen e tyre personale të aplikimit (CV-në, komunikimin në biznes, arritjet tuaja, shkathësitë, profilin tuaj online) në mënyrë që studentët të përgatiten për prezentim të mirë në botën e biznesit duke projektuar kështu profilin tuaj profesional në botën e punës. Përmes workshopeve/punëtorive që do të organizohen, ligjeratave dhe ushtrimeve si dhe bashkëpunimit me Zyrën e Karrierës kjo lëndë ka për qëllim të jetë sa më interaktive. Gjithashtu, ndërlidhja me botën e industrisë duke sjellë tek Ju përvojat reale nga sektorët përkatës do të kontribuojë praktikisht në këtë lëndë. Përveq kësaj, kjo do të jetë mundësi e mirë që të krijohen lidhje të reja me punëdhënësit potencial. Qëllim tjetër i lëndës është që të mësojmë duke punuar, gjë që nënkupton ndërlidhjen e studentëve me tregun e punës përmes praktikave që do të realizohen në pjesën e dytë të lëndës si pjesë mbështetëse e përvojës së të mësuarit. Kjo do të ju ndihmojë studentëve të bëjnë lidhjen në mes të pjesës teorike me atë praktike.

### Rezultatet e pritura të lëndës

Rezultatet e pritura të lëndës: -Rezultatet e pritura të kësaj lënde janë: Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: - Të jetë i gatshëm për punë dhe të kuptojë rëndësinë e të qenit diplomant në sektorin bankar ose atë të menaxhimit; të reflektojë mbi qëllimet e veta të karrierës për zhvillimin e tij personal dhe profesional - Të jetë kompetent në demonstrimin e shkathësive që lidhen me intervistimet dhe të shkruarit në nivel profesional, të jetë komunikues i mirë dhe konfident

gjatë bashkëpunimit me kolegë të ndryshëm. - Të jetë në gjendje të komunikojë në mënyrë efektive dhe të ketë shkathtësitë dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve të fushës së tij duke marrë për bazë përvojën personale të bazuar në punët/praktikat paraprake. - Të jetë në gjendje të vetë-vlerësojë

- progresin e vet duke zhvilluar atributet prej një profesionisti
- 

## Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Prezentimi i plan-programit të lëndës Punësoria për përgatitjen e dosjes personale, prezentimi i vetvetës me anë të shkrimit	Studentët njihen me planprogramin e lëndës, metodologjine e vlerësimit, organizimit e lëndës, metodat e vlerësimit dhe literaturën. Zhvillimi një CV-je të targetuar, workshop për përgatitjen e CV-së, hyrje në shkrimin e aplikacioneve të kualitetit të lartë.
2	Hulumtimi i tregut dhe Punësoria për përgatitjen e Letrës së Motivimit	Shkrimi i një letre të mirëfilltë të motivimit, definimi, rëndësia, shembuj praktik
3	Punësoria për komunikimin në biznes	Komunikimi efektiv në biznes/industri, rëndësia, aplikimi. Guest Lecture Communication Specialist
4	Karriera ne Sektorin Bankar	Menaxhmenti i lartë- TEB bank
5	Punëtori për krijimin e prezenteve	Rëndësia e prezenteve kuptimplotë dhe profesionale, shembuj praktik
6	unëtori për përgatitje per interviste për punë	Sesion këshillimi për intervistë, Përgatitja për intervistë, hulumtimi paraprak, (simulim te intervistes)
7	Punëtori për business etiquette	Sjellja profesionale në botën e biznesit, networking e mbështetur me shembuj praktik
8	Guest Lecturer	
9	Guest Lecturer	
10	Guest Lecturer	
11	Guest Lecturer	
12	Praktike ne Korporate dhe Banke , minimumi 1 muaj jo me shume se 3 muaj	

### Informata shtesë 1:

Do të mbahen 10 deri 12 sesione ligjerata dhe ushtrime, si dhe minimum 5 javë praktikë në njërin nga korporatat dhe/ose institucionet bankare partnere. Praktikat disa mujore që do t'i kryejnë studentët, do t'i përgatisë ata për karrierë, si dhe do t'i ndihmojë studentët për të kuptuar rolin e njohurive të fituara gjatë studimeve – të transferueshme në botën e punës.

### Informata shtesë 2:

Çfarë mund t'ju lehtëson përvetësimin me sukses të lëndës? • Ju duhet të keni njohuri se cila njësi do të shtjellohet gjatë javës, prandaj kërkohet nga ju që të shikoni syllabusin dhe të lexoni njësinë mësimore paraprakisht për të rifreskuar njohuritë e juaja. Më lehtë do ta kutponi ligjeratën. • Është shumë me rëndësi vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve. Keni parasysh se moduli është i bazuar në punë praktike, simulime dhe diskutime si dhe do t'ju udhëzoj për literaturë shtesë që mund të përdorni për të zgjeruar njohuritë e juaja. • Angazhohuni aktivisht gjatë diskutimeve në ligjëratat dhe gjatë punës në grupe. Kjo do t'ju ndihmojë të kuptoni më mirë njësinë e cila shtjellohet dhe poashtu angazhimi juaj vlerësohet. • Për çështjet të cilat nuk i keni kuptuar, çdo herë konsultohuni me mësuesin. Shpresojmë se kjo lëndë do të jetë e këndshme, sfiduese dhe inspiruese. Mbi të gjitha kjo lëndë është dizajnuar për ju dhe për adaptimin tuaj në jetën biznesore prandaj dhe sa më shumë që angazhoheni aq më shumë do të përfiton.

**Vlerësimi:**

Nr.	Lloji Vleresimit	Perqindja	Pershkrimi
1	Detyra	30	Pergatitja e dosjes personale te aplikimit. Detajet jane ne platforen E-learning
2	Pjesëmarrja	20	Pjesemarrje ne kete lende eshte obligative dhe perben 20% te vleresimit te pergjithshem
3	Provimi Final	50	Kjo lende nuk ka provim final, si vleresim final ju do ta keni perfundimin e praktikës ne njerën nga korporatat ose bankat partnere te Riinvestit

**Kushtet e përsëritjes:**

Sipas rregullores së studentëve të Kolegjit Riinvest, studenti ka të drejtë deri në tri herë të tentojë ta kalojë lëndën. Nëse studenti nuk arrin që ta kalojë lëndën në mundësinë e parë në fund të ligjëratave, atëherë vlerësimet e mëhershme, si psh. vijueshmëria, do t'i ruhen studentit deri në afatin e fundit për ta kaluar këtë lëndë. Nëse studenti nuk arrin që ta kalojë lëndën deri në mundësinë e tretë (afati i Shtatorit), atëherë studenti duhet ta përsërisë lëndën edhe një herë.

**Burimet:**

- - Ligjeratat e autorizuara nga mësimdhënësi i lëndës (sllajde dhe materiale shtesë për lexim) - Bolton, G.E.J. (2014) Reflective Practice: Writing and Professional Development, SAGE Publications Ltd. - Cottrell, S., (2011), Critical Thinking Skills: Developing Effective Analysis and Argument, Palgrave: Basingstoke - The Guardian Guide to Careers edt by Jimmy Leach - Artikuj nga burime të ndryshme fizike dhe elektronike

**Ndërtimi i ECTS-ve**

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	30	
Ushtrime:	15	
L+U:	45	
Seminar/praktike.:	80	
Studim i vazhdushem:	10	
Pregaditja e Provimit:	10	
Pjesemarrja ne teste:	4	
Pjesemarrja ne provimin final:	2	
Me profesorin dhe asistentin:	4	
Total Ore:	155	
ECTS:	6	